



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D I M

Nr. 9 datë 30.8.2007

PËR

SHFRYTËZIMIN E ZHAVOREVE DHE RËRAVE NË ZONAT ME
RREZIK PERMBYTJE

Në mbështetje të neneve 6,38 dhe 46, të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996, "Për rezervat ujore", të studimit "Vlerësimi i pasojave, ndikimit mjedisor problemeve hidrodinamike dhe rehabilitimi i gjendjes në shtretërit e lumenjve", i realizuar në zbatim të vendimit nr.760, datë 13.11.2003, të Këshillit të Ministrave, si dhe të dy studimeve "Per mbrojtjen e degradimit të shtreterve të lumenjve", të kryera në vitin 2006, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli Kombëtar i Ujit


V E N D O S I:

1. Lejohet shfrytëzimi i zhavorreve dhe i rërave, në zonen midis urave, në lumin Mat, sipas studimit të KBU- Mat.
2. Lejohet shfrytëzimi i zhavorreve dhe rërave, në lumin Drin, në zonen Ashte-Berdice, sipas studimit perkates.
3. Lejohet shfrytëzimi i zhavorreve dhe rërave, në lumin Shkumbin, në zonen e Thanasaj, sipas studimit perkates.

4. Me perjashtim te rezervuarit te Bovilles, mbi bazen e studimeve , lejohet shfrytezimi i inerteve qe derdhen lumenjte dhe perrenjte, ne liqenet dhe rezervuaret e ndryshem .
5. Lejet e shfrytëzimit te jepen në përputhje me ligjin nr.8093, datë 21.3.1996, “Për rezervat ujore”,si dhe me procedurat e miratuara nga Këshilli Kombëtar i Ujit.
6. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, dhe Këshillat e Baseneve Ujëmbledhëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI



SALI BERISHA

ZËVENDËSKRYETARI



LUFTER XHUVELI

Lufter XHUVELI

Minister i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave

Bujar NISHANI

Minister i Brendshem

Ridvan BODE

Minister i Financave

Genc RULI

Minister i Ekonomise, Tregetise dhe Energjitikes

Sokol OLLDASHI

Minister i Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

Nard NDOKA

Minister i Shendetsise

Jemin GJANA

Minister i Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit